



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 335/17 prot

Durrës, më 04.02 . 2026

VENDIM

Nr. 14, datë 04.02.2026

PËR

**"KRIJIMIN DHE INTEGRIMIN E ZYRËS SË TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJISË (ZTT) NË STRUKTURËN E QENDRËS SË STUDIMEVE
NDËRDISIPLINORE TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, në mbështetje të Planit të Zhvillimit Strategjik 2025-2030 të UAMD-së; në propozimin në kuadër të Aleancës STARS EU, të shkresës nr.309 prot., datë 03.02.2026 të DBNJ, (bashkëlidhur), Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.02.2026,

VENDOSI:

1. Krijimin dhe integrimin e Zyrës së Transferimit të Teknologjisë (ZTT) në strukturën e Qendrës së Studimeve Ndërdisciplinore të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kjo Zyrë ka si mision:
 - Nxitjen koordinimin dhe mbështetjen e transferimit të njohurive, teknologjisë dhe inovacionit nga universiteti drejt shoqërisë dhe tregut;
 - Vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor dhe ekspertizës akademike të UAMD-së;
 - Forcimin e rolit të universitetit në zhvillimin ekonomik, social dhe rajonal, në përputhje me parimet Strategjike të UAMD-së.
3. ZTT do të ushtrojë funksion koordinues për krijimin e një oferte të harmonizuar të transferimit të teknologjisë, duke:
 - Identifikuar kapacitetet kërkimore, laboratorët, infrastrukturën shkencore dhe ekspertizën e stafit akademik nga të gjitha njësitë akademike;

- Strukturuar dhe promovuar shërbime konsulence, studime, analiza, zgjidhje inovative dhe shërbime të bazuara në njohuri;
 - Mbështetur bashkëpunimin me sektorin privat, institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile.
4. Funksionimi i ZTT-së do të realizohet përmes organizimit të brendshëm të punës, pa shtesë në strukturë, duke ndarë detyrat sipas nevojave.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
- Zv. Rektor për kërkimin shkencor
 - Drejtuesit e njësive kryesore
 - Drejtoria e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë
 - Struktura Challenge Lab të STARS EU me grupet e punës përkatëse
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

